



## **PROGRAMI POLITIK, VLERAT DHE PARIMET, POLITIKAT KRYESORE TË PARTISË SË LIRISË**

Partia e Lirisë krijohet për të çuar më tej misionin e Lëvizjes Socialiste për Integrim, si kërkesë për përfaqësimin e një baze më të gjerë zgjedhore e ideologjike, në kushtet e jashtëzakonshme të keq-qeverisjes dhe të shpopullimit të vendit.

Në realitetin e sotëm politik shqiptar, partitë politike kanë tejkaluar dhe kanë tjetërsuar përkatësinë në spektrin politik. Sistemi demokratik është dëmtuar në themelin e tij, në zgjedhjet e lira e të ndershme, dhe për rrjedhojë pozicionimi ideologjik i partive është i parëndësishëm në politikë-bërje dhe në efekte elektorale.

Përkatësia ideologjike, si themel i formulimit të politikave të mazhorancës, që sot kontrollon të gjithë pushtetet, ka kohë që është zëvendësuar me autokracinë dhe arrogancën qeverisëse që ka dale jashtë çdo lloj modeli politik të majtë apo të djathtë dhe ka tashmë tiparet e një regjimi korruptiv oligarkik, jo demokratik, që nuk respekton vullnetin e qytetarit, që pasurohet nga resurset dhe të mirat që i përkasin publikut, dhe që e përdor këtë pasurim për të blerë pushtetin dhe sovranitetin e qytetarit dhe votuesit të thjeshtë.

Modeli aktual i qeverisjes funksionon duke:

Grabitur dhe blerë vullnetin e qytetarëve nëpërmjet kërcënimit me privimin e të ardhurave jetësore të individit dhe familjeve, si dhe duke angazhuar hapur botën e krimin në grabitjen e pushtetit.

Shkelur ligjet, rregullat dhe ligjin themelor të shtetit, Kushtetutën.

Grabitur pronën publike dhe atë private në funksion të pasurimit të tejskajshëm personal.

Evituar plotësisht përgjegjësinë dhe llogaridhënien përpara qytetarëve.

Krijuar një ekonomi kombëtare në funksion të pasurimit të kryeministrit dhe klanit rreth tij, duke sjellë defekte të rënda në funksionimin e qëndrueshëm të ekonomisë.

Fuqizuar grupe biznesi të lidhura me krimin dhe grupe mediatike në shërbim të verbër të qeverisjes dhe deformimit të opinionit publik.

Polarizuar shoqërinë dhe duke krijuar një hendek të madh mes një pakice super të pasuruar dhe varfërimit të qytetarëve të tjerë, dhe duke mos realizuar rritjen e pagave dhe të ardhurave të qytetarëve si dhe duke dështuar në mbrojtjen e qytetarëve nga inflacioni dhe rritja e çmimeve.

Injoruar përkatësinë historike, kulturore, identitare, si dhe integritetin e paprekshmërinë e territorit.

Shkatërruar vlerat bazë të familjes si qelizë e shoqërisë si dhe marrëdhëniet në një familje të shëndoshë.

Injoruar rëndësinë e vitalitetit demografik të kombit dhe fenomenin e pasojat e rënda të shpopullimit.

Treguar papërgjegjshmëri të plotë për jetën e mirëqenien e qytetarit të zakonshëm.

Ndjekur një politikë egocentrike, amatoreske në politikën e jashtme, duke krijuar hendek dhe duke dëmtuar pozitën ndërkombëtare të Kosovës.

Ngadalësuar e vonuar për mbi një dekadë procesin e integritit të vendit në BE.

Si dhe duke e mbuluar keq-qeverisjen me një fasadë propagandistike të gënjeshtërt për të mashtruar opinionin.

Në këto kushte, Partia e Lirisë, vendos si kauza dhe objektiva madhore të saj:

- 1. Forcimin e lirive politike, ekonomike, dhe të drejtave të qytetarëve, kthimin e vendit në normalitet demokratik ku vullneti i qytetarëve zgjedh qeverisjen dhe imponon llogaridhënien e saj, duke zbatuar referendumin si formë të demokracisë direkte dhe si garantor se vullneti i qytetarëve nuk mund të merret peng nga keq-qeverisja.*
- 2. Transformimin e qeverisjes në shërbëtoare të qytetarëve dhe jo të krrimit dhe të oligarkëve, duke vënë individin dhe familjen e tij si përfitues kryesor të zhvillimit dhe rritjes ekonomike.*
- 3. Transformimin e sistemit arsimor duke synuar formimin e qytetarëve që ruajnë dhe fuqizojnë demokracinë, ekonominë e tregut të lirë dhe të drejtat e liritë, që e duan atdheun e shqiptarinë dhe që janë krenarë për përkatësinë e tyre mes kombeve të tjera evropiane.*
- 4. Çlirimin e ekonomisë nga korrupsioni, nga monopolet dhe interesat klienteliste për biznes dhe investime, duke garantuar rritjen e punësimit dhe të pagave si dhe paga dinjitoze për këdo që punon ndershmërisht.*
- 5. Mbështetje reale për shtresat në nevojë, duke rivlerësuar të ardhurat jetike dhe duke i mbrojtur këto shtresa nga efektet e inflacionit, të rritjes së çmimeve, si dhe nga risku i mënjanimit nga shërbimet jetike publike si arsimimi dhe shërbimi shëndetësor.*
- 6. Ndalimi i shpopullimit të vendit dhe krijimin e besimit tek çdo shqiptar, veçanërisht tek të rinjtë, se Shqipëria është vend i bekuar nga Zoti, ku ata janë zotër dhe kanë mundësi të ndërtojnë jetën e tyre dhe familjeve të tyre në siguri, liri e prosperitet. Shqipëria u përket të rinjve!*

Prandaj, për të arritur objektivat e saj, **PARTIA E LIRISË**, do të jetë parti e kauzave kombëtare, parti gjithëpërfshirëse për të gjithë ata që duan

demokracinë, Kushtetutën dhe ligjin, që duan punën, që duan familjen dhe atdheun.

\*\*\*

## KAUZAT DHE OBJEKTIVAT

- 1. Forcimi i lirive politike, ekonomike, dhe të drejtave të qytetarëve, kthimi i vendit në normalitet demokratik ku vullneti i qytetarëve zgjedh qeverisjen dhe imponon llogaridhënien e saj, duke zbatuar referendumin si formë të demokracisë direkte dhe si garantor se vullneti i qytetarëve nuk mund të merret peng nga keq-qeverisja.***

Demokracia vdes kur vullneti i popullit deformohet, vidhet dhe blihet me kërcënim, ku liritë, të drejtat, ligji dhe kushtetuta nuk respektohen, kur rregullat dhe normat e saj mbeten në dorë të qeverisë për t'u respektuar ose jo, kur institucionet garantuese të ligjit dhe të sistemit demokratik humbasin aftësinë e kontrollit dhe balancës. Në kushtet kur qeverisjet uzurpojnë pushtetin dhe shkatërrojnë sistemin e zgjedhjeve të lira e të ndershme, qytetarëve u mbetet vetëm një mënyrë demokratike të shprehin sovranitetin e tyre: Referendumi. Partia e Lirisë do të mbështesë dhe sanksionojë institucionalizimin e referendumit si forca e demokracisë direkte, si garanci e sovranit popull nga çdo deformim i vullnetit të tij nga përfaqësuesit e zgjedhur. Partia e Lirisë beson se efektet e institucionalizimit të këtij instrumenti demokratik janë të shumëfishta, në drejtim të përmirësimit të qeverisjes, llogaridhënies së saj përpara qytetarëve, angazhimit cilësor civil dhe politik të qytetarëve në politikë-bërje dhe rritjes së besimit të humbur të qytetarit tek politika.

Partia e Lirisë do ta ketë prioritar miratimin e ligjit për referendumet, me qëllim që të bëjë të mundur zbatimin real të së drejtës kushtetuese për organizimin e referendumeve.

- 2. Transformimi i qeverisjes në shërbëtore e qytetarëve dhe jo të krimin dhe të oligarkëve, duke vënë individin dhe familjen e tij si përfitues kryesor të zhvillimit dhe rritjes ekonomike.***

Sot, qeverisja ka degjeneruar në një instrument në shërbim të bizneseve të mëdha klienteliste, grupeve bizneso-mediatike dhe grupimeve kriminale pranë saj, të cilat janë bërë njësh me qeverisjen dhe janë përfituesit e mëdhenj të parave publike nëpërmjet PPP-ve, prokurimeve të drejtëpërdrejta apo formave të tjera që kanë shkatërruar konkurrencën dhe kanë mbyllur hapësirat e bizneseve të ndershme për të realizuar investime publike.

Ndërkohë, asnjë vëmendje nuk është treguar për përfitimin e qytetarit, punëtorit, mësuesit, pedagogut, inxhinierit, mjekut, profesionistit e biznesmenit të thjeshtë, nëpërmjet rritjes dhe indeksimit të pagave, apo mbrojtjes nga rritja e jashtëzakonshme e çmimeve të produkteve të konsumit, të energjisë dhe shërbimeve.

Partia e Lirisë do ta shkëpusë qeverinë dhe qeverisjen nga kontrolli i grupeve bizneso-mediatike, për ta kthyer në shërbim të qytetarëve. Partia e Lirisë do të miratojë Ligjin për Indeksimin e Pagave që ajo ka paraqitur në Kuvend, dhe do të vendosë një lidhje të drejtëpërdrejtë të rritjes ekonomike me rritjen e të ardhurave për çdo individ dhe familje.

***3. Transformimi i sistemit arsimor duke synuar formimin e qytetarëve që ruajnë dhe fuqizojnë demokracinë, ekonominë e tregut të lirë dhe të drejtat e liritë, që e duan atdheun e shqiptarinë dhe që janë krenarë për përkatësinë e tyre mes kombeve të tjera evropiane.***

Demokracitë e konsoliduara, shoqëritë e zhvilluara dhe me prosperitet kanë qytetarë të arsimuar mirë, me kërkesa të larta ndaj cilësisë së qeverisjes, që si individë apo të organizuar në parti apo organizata të shoqërisë civile detyrojnë llogaridhënien e përfaqësuesve të zgjedhur dhe të qeverive. Shqipëria dhe shqiptarët kanë nevojë, sot më shumë se kurrë, për cilësi më të lartë të arsimimit të tyre si profesionistë dhe si qytetarë, për t'i dhënë fund një herë e përgjithmonë fenomenit mbi të cilin abuzon qeverisja e sotme e Rilindjes, sime shqiptarët mund të qeverisësh si të duash, se janë popull pa ndjenjën e protestës.

Në mënyrë të padiskutueshme, forcimi i rolit të qytetarit si aktor dhe faktor politik, shkon në të njëjtin kah me forcimin e identitetit dhe ndjenjës kombëtare. Roli i shkollës në një mision të tillë është i pazëvendësueshëm. Prandaj, investimi në sistemin arsimor në të gjithë zinxhirin e tij, duke filluar nga çerdhet e kopshtet, rritja e cilësisë së shkollës për të edukuar qytetarin evropian të Shqipërisë janë një kauzë e madhe e Partisë së Lirisë dhe investimi strategjik më i rëndësishëm i saj.

***4. Çlirimi i ekonomisë nga korrupsioni, nga monopolet dhe interesat klienteliste për biznes dhe investime, duke garantuar rritjen e punësimit dhe të pagave si dhe paga dinjitoze për këdo që punon ndershmërisht.***

Korrupsioni i tejskajshëm, orientimi preferencial i investimeve nga qeveria tek klientët e saj, kanë shkatërruar klimën e biznesit dhe kanë deformuar strukturën ekonomike të vendit, larg qëndrueshmërisë, bazuar tek lëndët e para të papërpunuara, shfrytëzimi i burimeve natyrore pa krijuar vlerë të lartë, tek puna me kosto të lirë dhe tek bujqësia, ku burimet e rritjes ekonomike janë me risk të lartë. Në 10 vite qeverisje të Rilindjes nuk u arrit të ndryshohej struktura e ekonomisë drejt një ekonomie prodhuese dhe shërbimesh cilësore, që krijojnë vlerë të lartë dhe me eksporte në rritje. Prandaj, tërheqja e investimeve është në nivelet më të ulta në rajon, dhe klima e biznesit në vendet më të ulëta të indeksit “Doing business”. Pasojat janë të ndjeshme në nivelin e pagave, ndër më të ulëtat në rajon.

Prandaj, krijimi i një ekonomie të tregut të lirë, të bazuar mbi konkurrencën e ndershme, me një strukturë ekonomike prodhuese e shërbimesh cilësore, që krijojnë vlerë dhe eksportin, krijimi i mjedisit më tërheqës për investime vendi dhe të huaja

në rajon, me taksa të ulëta, me siguri ligjore për investitorët, me qëllim rritjen e vazhdueshme të punësimit dhe të pagave, përben një kauzë tjetër madhore të Partisë së Lirisë.

**5. Mbështetje reale për shtresat në nevojë, duke rivlerësuar të ardhurat jetike dhe duke i mbrojtur këto shtresa nga efektet e inflacionit, të rritjes së çmimeve, si dhe risku i menjanimit nga shërbimet jetike publike si arsimimi dhe shërbimi shëndetësor.**

Fytyra humane e çdo shoqërie dhe qeverisjeje shihet tek mënyra si i trajton shtresat në nevojë, të cilat për arsye të qenësishme nuk mund të punojnë dhe të shpërblehen denjësisht nga puna e tyre. Aktualisht shpenzohet 9% e buxhetit për mbrojtjen sociale, një shifer tepër e ulët e krahasuar me mesataren prej 28 % të vendeve të BE. **Përcaktimi i pagës së jetesës do të jetë një objektiv i rëndësishëm i Partisë së Lirisë krahas rritjes të vazhdueshme të ndihmës sociale për përfituesit e saj.**

**6. Ndalimi i shpopullimit të vendit dhe krijimi i besimit tek çdo shqiptar, veçanërisht tek të rinjtë, se Shqipëria është vend i bekuar nga Zoti, ku ata janë zotër dhe kanë mundësi të ndërtojnë jetën e tyre dhe familjeve të tyre në siguri, liri e prosperitet.**

Shpopullimi që po i ndodh vendit është një fenomen që dëmton rëndë vitalitetin e shoqërisë sonë, aftësinë e saj për t'u rritur, zhvilluar e garantuar ekzistencën, për të qenë e suksesshme në një mjedis tepër konkurrues mes kombeve të tjera në rajon dhe në Evropë ku vendi ynë po integrohet, është një humbje e madhe për vitalitetin demografik të vendit, një humbje e madhe ekonomike për investimin që shoqëria ka bërë për arsimimin e tyre dhe për fuqinë punëtore të munguar, një dhimbje e madhe për familjet që i përjetojnë.

Largimi masiv i shqiptarëve detyrohet nga mungesa e shpresës se vendi mund t'i ofrojë atyre kushte më të mira për punësim me të ardhura dinjitoze, për sigurinë e jetës, sigurinë fizike, atë shëndetësore e juridike. Qeverisja aktuale e injoron këtë fenomen dhe konsideron si të natyrshëm largimin e shqiptarëve.

Partia e Lirisë do të ketë si kauzë madhore ndaljen e shpopullimit të vendit dhe kthimin e shqiptarëve pranë familjeve të tyre, për të realizuar plotësimin dhe prosperitetin e tyre personal dhe për të gëzuar zhvillimin e prosperitetin e vendit me gjithë pasuritë e të mirat që i ka dhënë Zoti.

\*\*\*

## **VLERAT DHE PARIMET E PARTISË SË LIRISË**

Të gjithë kauzat dhe objektivat madhore të Partisë së Lirisë përshkohen nga tipari themelor i shoqërisë moderne: LIRIA.

LIRIA është në politikë, për të zgjedhur e për t'u zgjedhur, për të marrë vendimet që prekin individin, familjen dhe shoqërinë në mënyrë të përfaqësuar ose drejtëpërdrejt në forma referendare: LIRIA është tek të drejtat e njeriut dhe zbatimi Kushtetutës dhe i ligjit, ku gjithëkush respektohet si i barabartë në të drejtat e tij dhe përpara ligjit; LIRIA është ekonomike dhe e tregut, për të realizuar aktivitet ekonomik, për të përfituar gjithësecili nga aftësitë sipërmarrëse, talenti dhe nga prona, pa patur frikë se ato do të pengohen dhe shfrytëzohen dhe tjetërsohen nga ata që kanë në dorë qeverisjen; LIRIA është të respektosh rregullat dhe ligjet e BE duke i kthyer ato në standarde që rregullojnë dhe garantojnë funksionimin dhe mirëqenien e individëve dhe shoqërisë.

LIRIA ka të bëjë me besimin e rinisë tek Partia e Lirisë dhe tek angazhimi i vetë atyre, se ata vetë, do të largojnë peshën e rëndë që i ka vënë keq-qeverisja Rilindase vendit dhe mundësive të tyre për arsimim, punësim, për krijimin e familjeve të tyre dhe për t'u ndjerë të sigurt dhe të lumtur në shtëpinë dhe vendin e tyre.

Partia e Lirisë është parti që bazohet në vlerat themelore të lirisë, të solidaritetit dhe drejtësisë për të arritur sigurinë dhe mirëqenien e individit dhe shoqërisë.

Për Partinë e Lirisë, LIRIA është një koncept themelor i shoqërisë ku jetojmë, që duhet të jetë një shoqëri e drejtë, e integruar, dhe me mundësi për këdo që do të përparojë dhe të jetë i suksesshëm.

Ne jemi kundër polarizimit të shoqërisë për qëllime politike dhe besojmë se interesi i shoqërisë dhe i publikut qëndron mbi interesin e çdo partie.

Për Partinë e Lirisë, liria është e mishëruar tek respekti pa paragjykim për çdo individ apo grup shoqëror pavarësisht nga kombësia, feja, bindjet politike, seksi, raca, aftësitë dhe pa-aftësitë.

Liria është gjithashtu një vlerë themelore e rregullimit të rendit dhe botës ku jetojmë. Partia e Lirisë beson se vlerat themelore të lirisë, sigurisë, të solidaritetit dhe drejtësisë janë udhërrëfyese edhe në politikën e jashtme. Para së gjithash, vjen liria dhe siguria e qytetarëve shqiptarë, pra, edhe politika e jashtme e PL është e ngritur mbi interesat tona kombëtare.

Angazhimi ynë në forcimin e këtyre vlerave realizohet edhe në kuader të aderimeve dhe anëtarësimeve në organizatat rajonale e ndërkombëtare, si pjesë e arktitekturës së lirisë dhe sigurisë të kontinentit tonë dhe rajonit trans-atlantik, si promovim i marrëdhënieve me shtete e kombe miq, me partnerët tanë në Evropë e përtej saj.

Ne besojmë së liritë e siguria e kombit tonë forcohet nga pjesëmarrja aktive në NATO dhe nga integrimi i plotë në BE.

Partia e Lirisë vlerëson se zbatimi në rajonin e Ballkanit i të njëjtave vlera që qëndrojnë në themel të BE rrit në mënyrë të vazhdueshme liritë dhe sigurinë e kombit shqiptar, si një popull kontributor i paqes dhe zhvillimit.

Për Partinë e Lirisë, liria është një atribut i lindur i qenieve njerëzore, dhe si e tillë nuk mund të kufizohet nga autoriteti dhe qeverisja. Përkundrazi, qeverisja duhet t'ja garantojë lirinë çdo individ. Por liria e çdo individ i sjell atij edhe detyrimin për të respektuar lirinë e individëve të tjerë.

Liria e një individ gëzohet në kushtet e një shoqërie të drejtë, ku individit i krijohen mundësitë sipas dëshirave dhe aftësive.

Liria është gjithashtu përgjegjësia për familjen dhe komunitetin, për shoqërinë dhe për vendin.

Shoqëritë e lira janë solidare. Individët e shoqërive të lira tregojnë solidaritet konkret për këdo që nuk ka mundur të përfitojë nga mjedisi i lirisë ku jeton. Kështu, solidariteti për të pamundurin sot dhe për brezat e ardhshëm, bëhet një detyrë e çdo individ në shoqëritë e lira.

Prandaj Partia e Lirisë mbështet shtresat në nevojë, më të dobët dhe ata që kanë mundësi të kufizuara, dhe projektin sot përfitime për brezat e ardhshëm me sistemet që iu ofrojnë çdo individ dhe shoqërisë, sigurinë.

Partia e Lirisë mbështet drejtësinë për çdo individ si dhe drejtësinë sociale. Drejtësi do të thotë barazi përpara detyrimeve dhe të drejtave. Drejtësia duhet të qëndrojë përpara mundësive që ofron një shoqëri e lirë, dhe përpara përfitimeve të saj.

Prandaj, Partia e Lirisë mbështet një sistem lirie dhe drejtësie sociale ku të gjithë janë të barabartë përpara ligjit, ku të gjithë janë të barabartë përpara mundësive për arsimim, punësim, shërbimeve të shëndetit, sigurisë së jetës që ofron shoqëria për çdo individ.

Partia e Lirisë beson së liritë dhe siguria e qytetarëve garantohen nga një shtet i fortë, që respekton vullnetin e qytetarëve dhe jep llogari përpara tyre. Sistemi demokratik kërkon udhëheqje politike por nuk mund të funksionojë pa llogaridhënie përpara publikut.



Demokracia direkte është garancia e funksionimit të shëndetshëm të sistemit demokratik. Garantimi i të drejtës për referendum është garantim i lirive dhe sovranitetit të sovranit, pra, i vetë demokracisë.

Për Partinë e Lirisë, institucionet e zbatimit të ligjit, me sistemin gjyqësor në themel të tyre, të lirë dhe të pavarur, dhe jo vegël të politikës, janë garancia për liritë dhe sigurinë e jetës së qytetarëve.

Partia e Lirisë beson së liritë e individëve dhe shoqërisë forcohen më shumë kur shoqëria civile flet me gjuhën e saj, kur ajo është e lirë, e përgjegjshme dhe e pavarur.

Partia e Lirisë është për një domosdoshmëri të formimit demokratik të opinionit publik. Arsimi, familja, shoqëria si e tërë, dhe qeverisja, kanë të gjithë çfarë përfitojnë nga individët dhe një shoqëri e formuar me parimet dhe vlerat demokratike.

Media, e lirë dhe e përgjegjshme, është një pushtet i rëndësishëm në funksion të forcimit të lirisë dhe të funksionimit demokratik të një shoqërie.

Partia e Lirisë mbështet lirinë dhe drejtësinë e grupeve dhe minoriteteve. Prandaj ne i mbështesim të drejtat e tyre pasi këto të drejta, e drejta e lirisë dhe drejtësisë së tyre prevalon në çdo qeverisje apo formë të organizimit të shtetit ku ata jetojnë. Prandaj Partia e Lirisë mbështet aspiratat e çdo komuniteti për të jetuar i lirë dhe për të gëzuar të drejtat e tij.

Ndërsa Partia e Lirisë mbështet fuqishëm lirinë e individit dhe shoqërisë, është marrëdhënia midis tyre që sjell realizimin dhe zhvillimin e përbashkët. Shoqëritë e zhvilluara përbëhen nga individë të realizuar, të plotësuar në objektivat dhe potencialin e tyre, që kanë edhe përgjegjësinë për individin, si dhe individit ka përgjegjësinë për shoqërinë.

Në këtë marrëdhënie mes lirisë dhe përgjegjësisë në themelin më të fortë qëndron familja. Familja është themeli i gjithë shoqërisë, vendi ku fillojnë të formohen individët e lirë e të përgjegjshëm, dhe ku garantohet vazhdimësia e brezave. Prandaj Partia e Lirisë e ka familjen e fortë e të qëndrueshme prioritare në politikën e saj. Prandaj, për Partinë e Lirisë, martesë mes burrit dhe gruas është një institucion themelor i familjes dhe garancia për vazhdimësinë e brezave. Ndonëse Partia e Lirisë respekton edhe zgjedhje të tjera që bëjnë individët e lirë.

Partia e Lirisë mbështet barazinë gjinore. Liria është për individët e të dy gjinive. Barazia në mundësi është një e drejtë themelore njerëzore. Politikën tona shkojnë në mbështetje të plotë të kësaj barazie.

Në një shoqëri të tillë, ku individët e lirë janë përgjegjës dhe solidarë për shoqërinë, për familjen dhe për të ardhmen, krijohet një kohezion social që forcohet nga përkatësia kombëtare, gjuha, trashëgimia, historia, dhe të gjitha së bashku forcojnë patriotizmin, krenarinë kombëtare dhe ndjenjën e përkatësisë.

Partia e Lirisë synon t'i forcojë këto vlera në procesin e integritimit në BE, edhe si anëtare të familjes Euro-Atlantike, edhe në marrëdhënie me fqinjët dhe me të gjithë vendet dhe kombet e tjera.

Partia e Lirisë është e ndërgjegjshme se bota sot jeton në një proces zhvillimi të vazhdueshëm dhe globalizimi, proces në të cilin çdo komb ka vendin e tij. Ne besojmë që liria dhe respekti reciprok, ligjshmëria dhe respektimi i të drejtave janë parime themelore të marrëdhënieve në rrjetet ndërkombëtare të marrëdhënieve dhe interesave.

Qenia pjesë e rrjeteve ndërkombëtare ka sfidat e saj madhore. Njohja e trendeve dhe zhvillimeve është tepër e rëndësishme për adoptimin në kohë dhe përfitimin prej tyre.

Sot jetojmë në një kohë kur ka rreziqe të mëdha të sigurisë dhe ekzistencës. Luftërat dhe rreziqet shfarosëse të tyre, pandemitë, ndryshimi i klimës, janë një realitet që ndodh, që jo vetëm nuk mund të mohohet por kërkon alokim energjish serioze për t'u përgatitur dhe për t'i përballuar.

Rrezik të madh për lirinë dhe sigurinë e shoqërisë sot përbëjnë lëvizjet e mëdha të popullsisë. Shpopullimi i vendit është një fenomen që duhet ndaluar në mënyrë urgjente, pasi rrezikon vazhdimësinë kombëtare demografike e ekonomike të kombit tonë. Partia e Lirisë është e përkushtuar për të ndaluar këtë fenomen duke gjetur zgjidhje dhe ndryshuar gjithë shkaqet kryesore të tij: mungesa e besimit, varfëria, papunësia, e veçanërisht keq-qeverisja. Që në thelbin e tyre janë mungesa e lirive për të realizuar aspiratat individuale dhe të shoqërisë.

Për Partinë e Lirisë arsimit është premisa më e rëndësishme për të realizuar mundësitë, dëshirat dhe talentet e individëve të lirë. Arsimimi është gjithashtu thelbi i formimit, i qytetarëve të lirë dhe të përgjegjshëm, i shoqërive të lira e solidare, që ruajnë liritë e tyre nga uzurpimi dhe keq-qeverisja. Prandaj, arsimi është kauzë dhe prioritet kryesor i PL si Parti e Lirisë.

Arsimi krijon mundësitë për realizim individual por edhe përgjegjësinë e individit ndaj shoqërisë, nëpërmjet kontributit cilësor me punën e tij për të krijuar vlerë materiale dhe shërbime. Prandaj, arsimi është edhe premisë themelore e një ekonomie që zhvillohet, që krijon vlerë, që konkurren suksesshëm në tregje të vendit e të huaja.

Për Partinë e Lirisë, sportet forcojnë vlerat njerëzore të lirisë, solidaritetit e mirëqenies. Ato ndikojnë drejtëpërdrejt në kohezionin social dhe në shëndetin publik.

Masivizimi i sporteve dhe mbështetja për sportin elitare janë për Partinë e Lirisë drejtime të rëndësishme, për të forcuar këto vlera. Performanca e suksesshme në arenën ndërkombëtare ndikon gjithashtu në forcimin e përkatësisë dhe krenarisë kombëtare.

Përsa i përket modelit të ekonomisë së tregut të lirë, Partia e Lirisë beson tek ekonomia sociale e tregut, si një model i shoqërisë, si një mundësi për të arritur lirinë, sigurinë dhe mirëqenien e individit dhe të shoqërisë. Ky model ekonomik i ka mundësitë të akomodohet edhe në sistemin e marrëdhënieve dhe konkurrencës në tregjet e ekonomisë globale.

Partia e Lirisë beson tek modeli ekonomik prodhues, me prioritarizim të sektorëve të ekonomisë që kanë potencial rritjeje, që krijojnë vlerë të lartë, që kanë mundësi eksportesh dhe punësimi të mirëpaguar. Partia e Lirisë është për përdorimin me përgjegjësi të taksave të qytetarëve, të parave publike, për reduktimin e borxhit dhe ndalimin me ligj të rritjes së tij; për formalizim të ekonomisë dhe transparencë të financave publike, për një sistem fiskal me taksa të thjeshta, të ulëta dhe të ndershme.

Partia e Lirisë beson tek punësimi për të gjithë. Puna e ndershme është në bazë të lirisë, të realizimit personal dhe realizimit të përgjegjësive individuale dhe sociale, të përgjegjësive ndaj familjes. Punësimi do të jetë qëllimi i politikave të Partisë së Lirisë.

Puna duhet të sjellë të ardhura të mjaftueshme për një jetë dinjitoze. Ne do të respektojmë parimin e drejtë se **kush punon më shumë, shpërblehet më shumë**.

Partia e Lirisë beson se lufta kundër varfërisë është luftë për lirinë e atyre që nuk kanë mundur të kapin dhe të shfrytëzojnë mundësitë që iu krijon një shoqëri e lirë dhe solidarë. Prandaj, lufta kundër varfërisë është detyrë për t'i shërbyer lirisë së individit dhe shoqërisë në tërësi.

Partia e Lirisë vlerëson se për të qenë të suksesshëm në ushtrimin e lirive individuale dhe përparimit si shoqëri e si kombe, duhet të bashkëpunojmë por edhe të konkurrojmë me shoqëritë dhe kombet e tjera. Prandaj rritja e konkurrueshmërisë, produktivitetit, adoptimi i inovacionit janë themelore për suksesin tonë në tregje dhe marrëdhënie me vendet e tjera.

Natyra e konkurrencës sot është në fushën e dijes, komunikimit, teknologjisë. Prandaj, për Partinë e Lirisë aftësimi në këto fusha është themelor. Sot, vendet e BE investojnë rreth 4 % të GDP-së për kërkim shkencor, inovacion dhe zhvillim. Konkurrimi me sukses ndaj tyre duhet të marrë parasysh këto nivele investimi.

Një vëmendje të veçantë Partia e Lirisë ka për energjinë, krijimin e mundësive të reja për gjenerimin e energjisë së gjelbërt, veçanërisht diellit dhe erës, me qëllim forcimin e pavarësisë energjetike dhe rritjen e sigurisë së furnizimit me energji të familjeve dhe

biznesit. Kjo kushtëzohet edhe nga konteksti i krizës energjetike të provokuar nga lufta në Ukrainë.

Partia e Lirisë vlerëson se burimet natyrore, mineralet, ujrat, natyra, flora dhe fauna, pyjet, duhet të ruajmë në mënyrë rigorozë balancën e ekosistemit, duhet të garantojmë përfitime për të gjithë qytetarët dhe me solidaritet e përgjegjësi për brezat e ardhshëm të vendoset një balancë mes shfrytëzimit të këtyre pasurive sot dhe nesër.

Partia e Lirisë është e angazhuar për të krijuar sistemin e sigurimit shoqëror të individëve. Ky koncept i sigurimit dhe solidaritetit shoqëror nuk bazohet vetëm tek mbështetja financiare. Por kombinon edhe përgjegjësinë sociale, mbështetjen nga shteti dhe angazhimin civil. Partia e Lirisë do të motivojë individët që të ushtrojnë përgjegjësitë e tyre brenda aftësive që kanë.

Për sistemin e sigurimit të pensioneve, Partia e Lirisë do të forcojë sistemin “paguaj ndërsa fiton”, por ndryshimet demografike, kërkojnë forma të reja, bazuar mbi parimin e solidaritetit social për ta tejkaluar këtë situatë, si skema suplementare.

\*\*\*

## **PROGRAMI I POLITIKAVE KRYESORE**

Për të arritur objektivat e saj politike, ekonomike dhe të të drejtave, Partia e Lirisë paraqet programin e saj përpara qytetarëve shqiptarë për të forcuar demokracinë, sundimin e ligjit, liritë dhe të drejtat individuale, për të forcuar ekonominë dhe rritur pagat, për t'i kthyer atyre shpresën dhe besimin se ky vend do të bëhet dhe se Shqipëria mund t'i ofrojë gjithësecilit shumë më tepër së çfarë i ofrojnë sot vendet ku emigrojnë.

## **REFORMAT INSTITUCIONALE DHE ANTIKORRUPSIONI**

Dëmi që Rilindja i ka bërë shtetit, zbatimit të ligjit, institucioneve është tepër i madh. Për të ecur drejt një shoqërie të lirë e të drejtë, ku qytetarët janë zot dhe të sigurt, është e domosdoshme ringritja e tyre.

Ringritja e shtetit ligjor, të shkatërruar nga sjellja autokratike e qeverisjes Rilindase dhe lufta kundër korrupsionit që ka mbërthyer çdo nivel të qeverisjes, do të realizohet nga:

Miratimi i ligjit për Referendumet, si instrument themelor i demokracisë direkte, si garantor i vullnetit të sovranit ku qeverisjet degjenerojnë, injorojnë llogaridhënien dhe interesin e qytetarit.

Përfundimi i reformës në drejtësi dhe korrigjimet përkatëse në zbatim të Kushtetutës, për të çliruar kontrollin e sistemit gjyqësor nga kontrolli i politikës.

Riorganizimi i shërbimeve, drejtorive, institucioneve, gjykatave për t'i shkuar më pranë qytetarit dhe aktivitetit ekonomik e social. Sot, përqendrimi i këtyre shërbimeve ka shkaktuar largimin e tyre nga qytetari duke qenë një arsye tjetër e rëndësishme për largimet masive për në emigracion dhe shpopullimin e vendit.

Legjislacioni i ri anti-korrupsion, duke shtuar dënime të rrepta për ata që angazhohen në akte korrupsioni aktive dhe pasive. Vendosijen e individëve, kompanive dhe organizatave që kryejnë akte korruptive në listën e zezë që i skualifikon përgjithnjë nga çdo kontrate publike.

Ndryshimi i ligjit për prokurimin publik për të bërë të pamundur ndërhyrjen politike në të, për të rritur transparencën dhe për të rritur efikasitetin e përdorimit të parave publike.

Partia e Lirisë do të rrisë rolin dhe kompetencat e Autoritetit të Konkurrencës, që do të jetë një mbrojtës real i ekonomisë së tregut dhe lirisë së të gjithë operatorëve kundër çdo monopolizimi apo oligopolizimi në kurriz të konsumatorit.

Roli i Kuvendit, të dalë nga zgjedhje të lira e të ndershme, do të forcohet nën kontrollin dhe monitorimin e ekzekutivit, të agjencive të varura prej tij, ku vend të veçantë zë Autoriteti i Konkurrencës dhe çdo institucion tjetër që garanton lirinë e tregut dhe mbrojtjen e qytetarit nga manipulimet dhe deformimet e tregut, nga monopolet e oligopolet.

## RENDI DHE SIGURIA

Forcimi i rendit dhe sigurisë për qytetarët është një prioritet kryesor i Partisë së Lirisë. Policia e Shtetit, institucionet ligj-zbatuese janë në shërbim dhe garantues të të drejtave të qytetarëve, për t'i bërë ata dhe familjet e tyre të ndjehen të mbrojtur e të sigurtë.

Forcimi i luftës kundër krimit të organizuar, terrorizmit, trafikëve, veçanërisht substancave narkotike dhe qënieve njerëzore, pastrimit të parave, etj. do të jetë çështja madhore e sigurisë.

Vëmendje të veçantë do të përqendrohet në goditjen e rrjeteve kriminale që trafikojnë qëniet njerëzore drejt Mbretërisë së Bashkuar dhe vendeve të tjera.

Institucionet e rendit dhe të zbatimit të ligjit do të forcojnë pavarësinë dhe profesionalizmin e tyre. Në bashkëpunim me agjencitë partnere do të krijohet zyra e konfiskimit të aseteve që vijnë nga aktivitetet kriminale, në perputhje me acqui-të e BE, do të forcohet koordinimi dhe shkëmbimi i informacionit, si dhe do të rritet efektiviteti i ndëshkimit të aktivitetëve të jashtëligjshme dhe forcimi i sigurisë së personit.

Do të konfiskohen asetet e krijuara nëpërmjet veprimtarive korruptive e kriminale (si incerenatorët), dhe do të përdoren kryesisht për programet e mbështetjes së rinisë dhe familjeve të reja.

Do të hartohet plani i veprimit për 'Task Forcen e Veprimit Financiar', që do të parandalojë pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, që do ta heqë Shqipërinë nga lista e vendeve nën monitorim për mungesa dhe mosrealizime strategjike.

## ADMINISTRATA PUBLIKE

Reforma e administratës publike është një nga dështimet më të mëdha të qeverisjes së Rilindjes. Një reformë e thellë e administratës publike do të realizohet drejt rritjes së profesionalizmit dhe pavarësisë reale nga politika.

Do të vlerësohen rastet e largimit të punonjësve nga administrata dhe do të respektohet e drejta e atyre që janë larguar në mënyrë të paligjshme.

Është një domosdoshmëri përgatitja e shërbimit civil me kualifikime cilësore për procesin e negociatave dhe integritet evropian, dhe për tërheqjen e investimeve në ekonomi.

Partia e Lirisë do të inkurajojë angazhimin në poste të administratës së lartë publike të profesionistëve të spikatur nga Diaspora.

## POLITIKA E JASHTME

Partia e Lirisë, me misionin për të rikthyer demokracinë funksionale në Shqipëri, shtetin e së drejtës dhe mbrojtjen e Kushtetutës, qëndron për një politikë të jashtme mbështetur në tre shtylla kryesore:

- Mbrojtjen e interesave kombëtare të vendit;
- Politikë Rajonale aktive të fqinjësisë së mire;
- Integrimin e plotë të Shqipërisë në Bashkimin Evropian;

Zbatimi i kësaj politike të jashtme do të bazohet në interesin kombëtar, me qëllim që të realizohet mbrojtja e interesave kombëtare dhe konsolidimi i pozitës së Shqipërisë në botë, si një vend që i kontribuon paqes, zhvillimit dhe sigurisë.

Kjo politikë e jashtme do të synojë përshtetimin e anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Për Partinë e Lirisë, politika e jashtme e Shqipërisë duhet të jetë produkt konsensual i institucioneve të politikë-bërjes dhe jo klienteliste, e zhvilluar në strategji të mirëpërcaktuara dhe afatgjata.

Partia e Lirisë do të angazhohet për rritjen e konsensusit dhe gjithëpërfshirjes, me një shprehje të qartë të vullnetit politik të të gjithë faktorëve, për të shmangur vonesat e mëtejshme në procesin e anëtarësimit drejt BE-së, duke u përqëndruar tek reformat e besueshme të kërkuara.

Partia e Lirisë është për forcimin e sigurisë evropiane duke fuqizuar bashkëpunimin dhe rolin e NATO-s në zonën Trans-Atlantike, në kontinentin Evropian, dhe më gjerë.

Partia e Lirisë është për funksionimin e rendit ndërkombëtar të bazuar në ligj dhe institucione ndërkombëtare, dhe e konsideron të papranueshme dhe të dënueshme

përdorimin e paligjshëm të forcës, në kundërshtim me parimet dhe legjislacionin e institucioneve ndërkombëtare që ruajnë rendin dhe paqen botërore.

Partia e Lirisë vlerëson se Ballkani Perëndimor është një rajon kyç për stabilitetin e Evropës, sepse këtu janë shumë të forta përpjekjet për penetrimin e aktorëve botërorë me interesa për të devijuar proceset e integrimit në BE dhe NATO ku rajoni është angazhuar. Përpjekjet e këtyre aktorëve dëmtojnë paqen dhe stabilitetin e rajonit dhe, si të tilla, duhen përballur me seriozitet dhe angazhim maksimal.

Për Ballkanin Perëndimor integrimi rajonal është një proces i domosdoshëm, jo vetëm për forcimin e paqes, për prosperitetin e të gjithë vendeve dhe si përgatitje për integrimin në BE.

Iniciativat gjithëpërfshirëse për integrimin, si Procesi i Berlinit dhe Tregu i Përbashkët Rajonal, s'mund të dublohen dhe zëvendësohen nga iniciativa alternative si Ballkani i Hapur, që janë përçarëse, rrisin mosbesimin midis të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe funksionojnë jashtë proceseve integruese Evropiane.

Partia e Lirisë konsideron se politika e jashtme e Shqipërisë ndaj vendeve të Ballkanit do të jetë prioritare dhe shpreh vullnet të plotë për bashkëpunim me të gjitha vendet e rajonit. Partia e Lirisë është vendosur të forcojë bashkëpunimin me Serbinë, Bosnjë Hercegovinën, Malin e Zi dhe Maqedoninë e Veriut, në kuadër të zhvillimit dhe respektimit të interesave të përbashkëta, si dhe perspektivës evropiane.

Një prioritet absolut në politikën e jashtme të Partisë së Lirisë do të jetë zhvillimi i mëtejshëm shumëplanësh i bashkëpunimit me Republikën e Kosovës.

Partia e Lirisë vlerëson efektin pozitiv që ka sjellë shteti i Kosovës në stabilitetin e rajonit dhe angazhohet për t'i fuqizuar më tej marrëdhëniet mbi bazën e partneritetit dhe larg çdo paternalizmi.

Partia e Lirisë vlerëson si domosdoshmëri forcimin e pozitës ndërkombëtare të Kosovës, dhe angazhohet për të bërë gjithçka kërkohet për të mbështetur njohjen e saj ndërkombëtare, dhe anëtarësimin e saj në organizat rajonale, Këshilli i Evropës dhe NATO, dhe si një vend anëtar me të drejta të plota në OKB.

Partia e Lirisë është për forcimin e aleancave me partnerët kryesorë strategjikë si Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimi Europian, Britania e Madhe, si dhe rivendosi e balancave të nevojshme me partnerët rajonalë, si Italia dhe Greqia, duke rritur bashkëpunimin me Gjermaninë, Austrinë, Francën, si vende me qëndrime të qarta gjeostrategjike dhe përkrahëse të kombit Shqiptar.

Partia e Lirisë vlerëson Shtetet e Bashkuara të Amerikës si aleatin kryesor strategjik, dhe angazhohet për forcimin e partneritetit në të gjitha fushat.



Partia e Lirisë i vlerëson marrëdhëniet me Britaninë e Madhe si thelbësore, për vetë rëndësinë që ajo ka për paqen dhe stabilitetin në Evropë e përtej saj, për luftën kundër trafikëve dhe krimit ndërkombëtar, për funksionimin e institucioneve ndërkombëtare, si dhe një potencial për zhvillimin e shkëmbimeve ekonomiko-tregtare.

Partia e Lirisë do të zhvillojë politikë aktive me vendet mike të Shqipërisë në Ballkan, si Turqia, Rumania, Bullgaria, Kroacia, për të ruajtur lidhjet tradicionale, por edhe në funksion të perspektivës së përbashkët evropiane.

Partia e Lirisë përkrah një politikë të jashtme aktive në mbështetje të realizimit të të gjitha iniciativave rajonale evropiane për zhvillim dhe siguri, si Iniciativa për Mesdheun, Iniciativa e Tre Deteve, Vendet e Visegradit, etj.

Ne përkrahim të gjitha iniciativat dhe marrëveshjet politike të bëra për rajonin e Ballkanit Perëndimor, si Marrëveshja e Dejtonit, Marrëveshja e Ohrit, etj., dhe mbetemi të angazhuar për realizimin me efektshmëri të qëllimeve të tyre në drejtim të garantimit të paqes, sigurisë dhe bashkëjetesës entike.

Partia e Lirisë është e angazhuar për të mbështetur dhe bashkëpunuar me partnerët ndërkombëtarë në luftën globale kundër korrupsionit, trafikëve ndërkombëtarë, krimit kibernetik, pandemive, ndryshimeve klimatike dhe krizave të tjera.

Partia e Lirisë e shikon një prioritet të padiskutueshëm zhvillimin me përparësi të diplomacisë ekonomike të Shqipërisë, për të promovuar ekonominë dhe biznesin shqiptar në botë, dhe për të rritur thithjen e investimeve të huaja në Shqipëri, si një element thelbësor për rritjen ekonomike dhe e punësimit.

Partia e Lirisë në kuadrin e kthimit të Shqipërisë në një ekonomi prodhuese dhe eksportuese, do të punojë për heqjen e barrierave jo-fizike doganore e kufitare me dy vendet fqinje Italinë dhe Greqinë, marrëdhëniet me të cilat i konsiderojmë parësore dhe strategjike që përfaqësojnë edhe dy portat e BE-së në kufijtë tanë, ku banojnë një numër i konsiderueshëm shqiptarësh.

Partia e Lirisë do të ketë një politikë të jashtme përkujdesëse dhe aktive me komunitetin Arbëresh në Itali, si një komunitet që vijon të ruajë dhe promovojë vlerat historike, tradicionale të kombit tonë.

Partia e Lirisë synon të realizojë një mbështetje për shqiptarët në gjithë trojet e tyre në rajon, si faktor paqeje, zhvillimi dhe integrimi.

## DIASPORA SHQIPTARE NË BOTË

Partia e Lirisë angazhohet për përkujdesje reale për Diasporën shqiptare, kudo ku ndodhet, dhe do të kërkojë angazhimin e saj për zhvillimin e vendit, duke e kthyer në një pol të rëndësishëm që merr pjesë në zhvillimin shoqëror të tij.

Është domosdoshmëri e evidentimi i saktë i saj, në vendet që jetojnë, si dhe angazhimi për vendosjen e kontakteve dhe mbështetjen e tyre.

Mbajtja gjallë e lidhjeve me atdheun mëmë, me gjuhën e kulturën, dhe krijimi i mundësive reale për të kontribuar në zhvillimin e vendit do të jetë një prioritet i Partisë së Lirisë.

Ne do të mbështesim pjesëmarrjen e Diasporës në zgjedhjet e përgjithshme të vendit dhe në referendume.

\*\*\*

## PROGRAMI I ZHVILLIMIT EKONOMIK DHE SHOQËROR

Shqipëria ka të ardhurat për banorë dhe pagë minimale më të ulëta krahasuar me vendet e rajonit.

Shqipëria ka nivelin më të lartë të çmimeve në përqindje të mesatares evropiane, krahasuar me vendet e rajonit. Veçanërisht niveli i lartë i çmimeve është për grup artikuj ushqimorë. Niveli i çmimeve për këtë grup artikujsh në Shqipëri është 82.5% e mesatares evropiane.

Është rritur më tej kosto e jetesës për shkak të rritjes galopante të çmimeve dhe mos rritjes së pagave, kryesisht në sektorin shtetëror. Pagat në administratën publike as nuk janë indeksuar dhe as nuk janë rritur nga viti 2017.

Niveli i varfërisë është më i larti krahasuar me vendet e rajonit. Niveli i varfërisë vazhdon të rritet për grupet sociale më të prekura me të ardhura në kufirin ose më pak se 5.5 dollarë në ditë.

Është ulur numri i të punësuarve dhe është rritur përqindja e papunësisë në moshat 15-29 vjeç.

Treguesit e borxhit publik janë përkeqësuar. **Në periudhën 2013 – 2021, produktiviteti i borxhit i matur si raport i zgjerimit të Produktit të Brendshëm Bruto kundrejt zgjerimit të stokut të borxhit është përkeqësuar ku për çdo 100 lekë të marrë borxh, prodhimi është zgjeruar në 84 lekë, në një nivel më të ulët se rritja e borxhit.**

Rritja e stokut të Projekteve e Partneritetit Publik Privat do të shtojnë rrezikun fiskal dhe qëndrueshmërinë e financave publike.

Shqipëria mbetet vendi me nivelin më të lartë të korrupsionit krahasuar me vendet e rajonit, ndërsa ka ekonominë më pak konkurruese në rajon.

## PROGRAMI I ZHVILLIMIT EKONOMIK

Struktura aktuale ekonomike, e bazuar në industrinë e ndërtimit që është kthyer në lavatriçen e parave të pista, ka sjellë pasoja të rënda në krijimin e një ekonomie të qëndrueshme, në dobësimin e klasës së mesme, në polarizimin ekonomik të shoqërisë ku një grusht njerëzish janë pasuruar tejskajshëm dhe pjesa tjetër është varfëruar.

Partia e Lirisë do të angazhohet për të ndërtuar një model të ri ekonomik. Partia e Lirisë synon të forcojë me politikat e saj ekonomike shtresën e mesme, si një domosdoshmëri për zhvillimin e vendit dhe shoqërisë.

Për të siguruar suksesin e zbatimit të modelit ekonomik është e domosdoshme që të krijohen kushtet për zbatimin e reformave, të cilat do të jenë:

1. Përmirësimin e klimës së biznesit duke ulur barrën fiskale dhe administrative, duke ndaluar praktikën fiskale diferencuese, favorizuese dhe klienteliste.
2. Ndalimin e shfrytëzimit të burimeve natyrore nga një grusht oligarkësh të cilët po mbysin perspektivën e zhvillimit ekonomik të vendit.
3. Rishikimin e kontratave të projekteve PPP, si dhe ndaljen e praktikave të mëtejshme korruptive klienteliste për financimin e projekteve PPP me mbështetje buxhetore ose me ofertë të pakërkuar, të cilat kanë rritur kostot e jetesës së qytetarëve dhe buxhetit të shtetit.
4. Ndryshimin me ligj të rritjes dhe vendosjen e një tavanit të nivelit të borxhit publik për të ndaluar rritjen e pakontrolluar të tij.
5. Miratimin e ligjit të rritjes dhe indeksimit të pagave, dhe të gjithëpagesave të mbështetjes sociale, me qëllim ruajtjen e nivelit të jetesës.

Modeli i ri ekonomik do të duhet të balancojë rritjen e prodhimit me rritjen e konsumit. Rritja e prodhimit do të mbështetet nga rritja e investimeve publike produktive dhe investimeve private. Modeli i ri ekonomik do të kërkojë përdorimin me efektivitet më të lartë të fondeve publike, si për të rritur investimet produktive, por dhe rritjen e shpenzimeve sociale për të rritur mirëqenien e qytetarëve dhe për të ulur nivelin e varfërisë. Kjo do të mundësojë që qytetari të jetë përfitues i rritjes ekonomike, i përfitimit nga shfrytëzimi i burimeve natyrore, i përfitimit nga produktiviteti i investimeve publike dhe përfitues nga të ardhurat e taksave të cilat paguan. Rritja e punësimit, e mirëqenies dhe ulja e kostos së jetesës do të jetë në qendër të politikës ekonomike.

Vëmendje prioritare do t'i jepet ndryshimit të kësaj strukture drejt rritjes së prodhimit të industrisë, duke filluar nga ajo agro-përpunuese, manifaktura, përpunimi i mineraleve dhe lëndëve të para të vendit, veçanërisht hidrokarbureve, dhe rritja e vlerës së shtuar të produkteve nga përpunimi i tyre. Kjo do të sjellë rritjen e eksporteve. Kjo do të krijojë mundësi të reja punësimi me paga të mirëpaguara.

## SHFRYTËZIMI I BURIMEVE NATYRORE DHE ENERGJETIKE

Vendi ynë ka burime natyrore të shumta minerale dhe energjetike. Deri më sot as buxheti e shtetit, as njësitë e vetëqeverisjeve vendore dhe as qytetari nuk janë përfitues të shfrytëzimit të këtyre burimeve.

Partia e Lirisë do të angazhohet në zgjerimin e prodhimit si dhe rritjen e përfitimit të vendit dhe qytetarëve nga shfrytëzimi i burimeve natyrore.

Për këtë prioritet do të jetë:

- Shfrytëzimi i pasurive natyrore kombëtare të shkoje tek qytetari.
- Ndërtimi i rrjeteve të ndërlidhshmërisë energjitike nëpërmjet rritjes së kapaciteteve të rrjetit të transmetimit të energjisë elektrike.
- Rritja e prodhimit të energjisë nëpërmjet liberalizimit, duke shfrytëzuar burime të pashtershme natyrore si uji, dielli, era, për të qenë të pavarur nga importi i energjisë elektrike.
- Mbështetjen me programe të drejtëpërdrejta, dhe kreditimit të prodhimit të energjisë elektrike.
- Mbështetje për energjinë e gjelbër, veçanërisht të diellit dhe erës. Përgatitja dhe miratimi i ligjit për të mundësuar futjen në rrjet të energjisë së tepërt të gjeneruar nga ekonomia shtëpiake.
- Ndërtimi i kapaciteteve të përpunimit të naftës dhe produkteve të tjera të hidrokarbureve.
- Rregullimi dhe mbikëqyrja e tregut të hidrokrabureve për të ndaluar praktikën e rritjes abuzive të çmimeve të cilat rrisin koston e biznesit dhe të familjeve shqiptare, dhe dëmtojnë interesin publik.
- Kontroll rigoroz i cilësisë së karburanteve dhe ulje e ndjeshme e koston e tyre në rreth 20 % duke ristrukturuar strukturën e koston (heqje e taksës së qarkullimit nga karburanti).
- Rritja e shkallës së pasurimit dhe përpunimit të mineraleve në vend me qëllim të rritjes së vlerës së eksporteve të tyre.
- Rregullime ligjore nisur nga praktikën më të mira përsa i përket rentës minerare, për të mbrojtur interesin publik dhe përfitimit të ndërsjellë të operatorëve private, të qeverisjes qendrore dhe lokale, si dhe të qytetarëve.
- Monitorimin dhe kontrollin e shfrytëzimit të paligjshëm të burimeve minerale dhe natyrore, dhe ndërprerjen e kontratave në rastin e mos respektimit të detyrimeve, të dëmtimit të mjedisit, dhe marrjen e masave të sigurisë.
- Realizimi me prioritet i rrjetit kombëtar të gazit dhe vendosja në funksionim i TEC-it të Vlorës.
- Aksion kombëtar për rikuperimin e ndotjes nga aktiviteti njerëzor i tokës, ujit dhe ajrit.
- Rritje e sipërfaqeve të gjelbërta në qytete të betonizuara nga politikat urbane të Rilindjes
- Ndalimi i menjëhershëm i masakrës mbi faunën e vendit nga gjuetia e paligjshme dhe abuzive.
- Vendosja në kontroll rigoroz e gjithë landfilleve jashtë standardeve që rrezikojnë ndotjen e ujërave nëntokësore dhe mjedisit në përgjithësi.
- Përgatitjen e planit kombëtar me masat kundër ndryshimit të klimës dhe ngrohjes globale.

## ZHVILLIMI I BUJQËSISË, BLEGTORISË DHE INDUSTRIISË USHQIMORE, SI DEGË KRYESORE ME POTENCIAL TË PASHFRYTËZUAR.

Bujqësia është një nga degët e rëndësishme të ekonomisë. Rritja e prodhimit bujqësor dhe blegtoral në kushtet aktuale, synon sigurimin e burimeve dhe rezervave të ushqimit dhe uljen e varësisë nga importet.

Partia e Lirisë në qeverisjen e saj do të angazhohet për:

- Nxitjen e prodhimit bujqësor-blegtoral, rritjen e përpunimit agro-industrial, rritjen e eksporteve dhe rritjen e burimeve dhe rezervave ushqimore për vendin.
- Mbështetjen financiare të bujqësisë duke synuar rritjen e investimeve publike dhe private si dhe uljen e kostos së lartë të inputeve bujqësore dhe të punimit të tokës.
- Rritjen e investimeve në bujqësi nëpërmjet mbështetjes me kredi të buta dhe fonde grant të fermerëve dhe sipërmarrësve.
- Nxitjen e prodhimit bujqësor dhe uljen e kostos së tij, duke ulur ndjeshëm barrën tatimore dhe tarifore për lëndën e parë në bujqësi dhe blegtori.
- Uljen e taksave dhe tarifave për naftën e bujqësisë dhe të peshkimit.
- Nxitjen e rritjes së numrit të krerëve dhe të prodhimit blegtoral duke rritur mbështetjen financiare me pagesa direkte për numër krerësh dhe për çdo njësi prodhimi të dorëzuar. Mbështetje direkte për rasatin, peshkimin dhe bletarinë.
- Mbikqyrjen dhe rregullimin e tregut të inputeve bujqësore, plehra kimikë, fidanë, fara, pesticide, etj për të penguar rritjen abuzive të çmimeve.
- Rritja e kapaciteteve dhe e mirëmbajtjes së sistemeve kulluese dhe vaditëse.
- Përfundimin e dhënies së certifikatave të pronësisë mbi tokën dhe krijimin e tregut të saj.
- Mbështetje me përparësi të investimeve në sipërmarrjet agro-turistike, garantimin e mbrojtjes dhe të certifikimit të tyre.
- Nxitjen dhe regjistrimin e markave shqiptare të prodhimeve bujqësore.
- Zbatimin e skemave të financimit të bujqësisë të orientuara drejt rezultatit sipas modeleve më të suksesshme të Maqedonisë së Veriut.
- Pajisja me Kartën e Fermerit për të mundësuar dhe garantuar zbritjen automatike të pagesës së TVSh-së për inputet bujqësore, (plehra kimike, fidanë, fara, naftë), dhe blegtorale, si ushqimi për blegtorinë, dhe përshpejtuar pagesat për rimbursimet dhe subvencionet.
- Krijimin dhe vënien në funksion të një platforme këshillimore dixhitale, për transferim të shpejtë të njohurive dhe të praktikave të mira të prodhimit tek fermerët. Parandalimin nëpërmjet saj të humbjeve nga dëmtuesit dhe sëmundjet tek bimët dhe kafshët. Vlerësim me anë të saj të treguesve të cilësisë së tokave, hartëzimin e parcelave, etj.
- Mbështetjen për krijimin e Shoqërive të Bashkëpunimit Bujqësor të orientuara drejt tregut dhe kërkesave të tij.

- Krijimin e Bursës Bujqësore për të parandaluar spekulimet me çmimet në shitblerje të prodhimeve në tregje.
- Zbatim me rigorozitet i masave kundër falsifikimit ushqimor, të produkteve bujqësore dhe blegtorale.
- Forcimi i sigurisë ushqimore në të gjithë zinxhirin prodhues sipas parimit nga ferma në tavoline. Garantim i imputeve dhe procesit të prodhimit të sigurtë. Ndërtimi i një laboratorit të kontrollit ushqimor për çdo qark.

## TURIZMI SI NJË SEKTOR KRYESOR I ZHVILLIMIT EKONOMIK TË VENDIT

Turizimi është një sektor prioritar i zhvillimit të ekonomisë së vendit, i rritjes së punësimit dhe zbutjes së varfërisë. Masat kryesore për zhvillimin e këtij sektori me potencial të lartë rritjeje janë:

- Ulja e barrës fiskale mbi njësitë akomoduese dhe operatorët turistikë.
- Rritja e investimeve publike dhe private në infrastrukturën e turizmit dhe shkollimin profesional në sektorin e turizmit.
- Zgjerimin e resorteve turistike të harmonizuara me zhvillimin e turizmit familiar në përputhje me legjislacionin dhe respektimin e pronësisë mbi tokën.
- Ndalimin e praktikave korruptive dhe vjedhjes së tokave publike dhe private duke cënuar interesin publik.
- Dhënien e paketave financiare familjeve për të nxitur turizmin brenda vendit sipas praktikave të vendeve të rajonit.
- Mbështetje të investimeve në porte (marina) turistike dhe prodhimin e mjeteve lundruese dhe industrinë e detit.
- Ruajtje e mbështetje e zejeve artizanale e artistike në funksion të industrisë turistike.
- Promovim i vlerave kulturore, etnografike, folklorit, artit në përgjithësi, arkitekturës tradicionale në funksion të turizmit.
- Promovim i trashëgimisë historike dhe arkeologjike.
- Rritje e cilësisë dhe profesionalizmit të shërbimit turistik, sipas llojeve të turizmit dhe specifikave rajonale, kategorizim i strukturave turistike të të gjitha llojeve.

## INFRASTRUKTURË E ZHVILLUAR DHE E PËRAFRUAR ME STANDARTET EVROPIANE

Infrastuktura e zhvilluar dhe cilësore me shërbimet që ajo ofron është një nga kontributorët më të rëndësishëm të të gjithë sektorëve të ekonomisë dhe kontribues

kryesor në rritjen ekonomike të vendit. Investimet në infrastrukturë nxisin zhvillimin e tregut dhe kanë një impakt social.

Sot, vendi përballet me mungesa të mëdha dhe pasiguri në infrastrukturën rrugore, kapacitet të reduktuar të infrastrukturës portuale dhe hekurudhore, shërbime jo cilësore të transportit urban dhe nder-qytetas, me sisteme ujësjellës me nivel të lartë humbjesh dhe kanalizime të papërfunduara, etj. Një dukuri e rëndomtë që çënon rëndë financat dhe interesin publik është një kosto tepër e lartë korruptive e investimeve në infrastrukturën rrugore.

Partia e Lirisë do të angazhohet në:

- Ndërtimin dhe zgjerimin e korridoreve strategjike dhe i rrugëve të reja për t'ju afruar mesatares të rrjetit rrugor për banorë me vendet e rajonit, sipas Samitit të Vjenes se 2015 për ndërlidhshmërinë e rajonit.
- Rritjen e sigurisë rrugore nga zbatimi i standardeve evropiane në ndërtimin e tyre dhe plotësimi me sinjalistikën rrugore.
- Analizë e kostove të shumëfishuara të veprave publike dhe marrja e masave për uljen e tyre në nivelin e rajonit dhe kostove të tregut ndërkombëtar të lëndëve të para.
- Rikonstrukcionin e akseve rrugore nacionale dhe mirëmbajtjen e rrjetit rrugor.
- Ulja e kostos, zgjerimin e kapaciteteve dhe përmirësimi i cilësisë së transportit publik urban dhe ndër-qytetas.
- Mbështetja financiare nga fondet publike dhe nga institucionet ndërkombëtare të zgjerimit dhe modernizimit të rrjetit hekurudhor duke synuar lidhjen me Kosovën, si dhe integrimin me rrjetin rajonal dhe evropian.
- Zgjerimin e porteve ekzistuese dhe ndërtimin e porteve të reja për të rritur kapacitetet e furnizimit me mallra për nevojat e vendit dhe të gjithë rajonit si dhe rritjen e flukseve turistike. Ndërtimi i infrastrukturës së nevojshme për industrinë rekreative të detit, porte dhe shërbime mbështetëse.
- Zgjatja e kohës së furnizimit me ujë të pijshëm. Realizimi i investimeve të nevojshme për të ulur humbjesh në ujësjellës kanalizime.
- Përmirësimi i sistemit të kanalizimeve të zonave urbane dhe rurale si detyrim për të ndaluar ndotjen e mjedisit.
- Rritja e depërtimit dhe promovimi i shërbimeve dixhitale për qytetarët dhe biznesin. Shërbim pa pagesë veçanërisht në shkolla fillore, të mesme, universitete dhe mjediset e banimit të nxënësve dhe studentëve.
- Vendosja e impianteve gjeneruese të energjisë hidro dhe fotovoltaike për të kompensuar konsumin e lartë në sistemet me pompa.
- Forcimi i sigurisë kibernetike dhe infrastrukturës kryesore të teknologjisë së informacionit të vendit
- Forcimi i masave kundër zjarrit.
- Forcimi i kontrollit në infrastrukturën strategjike të vendit, aktualisht në procese koncesionare.



- Trajtimi i mbetjeve urbane sipas standardeve të BE.

## INVESTIM NË ARSIM PËR FORCIMIN E KAPITALIT NJERËZOR DHE LIDHJEN ME TREGUN E PUNËS.

Politikat e arsimit do të jenë të orientuara drejt rritjes dhe fuqizimit të kapitalit njerëzor, aftësimin të tij për kërkesat e tregut të punës, formimit të studentëve si qytetarë të angazhuar që garantojnë sistemin demokratik, vlerat morale e sociale të shoqërisë, si dhe formimit të tyre si drejtues të ekonomisë dhe politikës. Për këtë, politikat tona do të përfshijnë gjithë zinxhirin e sistemit arsimor:

- Rritje e buxhetit për arsimin në mesataren e BE si përqindje e PBB. Buxheti për arsimin do të plotësohet krejtësisht sipas nevojës për financim, në mënyrë prioritare.
- Të shtohet numri i vendeve dhe çerdhet e kopshtet si emergjencë pasi kapacitetet e tyre, sidomos në zonat urbane, janë shumë më pak se nevojat.
- Të rrisë pagat për mësuesit dhe pedagogët brenda një mandati qeverisës dhe të rregullojë profesionin e mësuesit me një status të veçantë që i garanton ata profesionalisht dhe ndihmon në rritjen e cilësisë dhe performancën në mësimdhënie.
- Të frenojë hemoragjinë e braktisjes së shkollës prej mësuesve në zonat periferike nëpërmjet masave nxitëse për mësuesit.
- Të standartizojë kurrikulën parauniversitare me qëllim që të integrohet edukimi demokratik në kurrikulën shkollore, të realizojë nxitjen e mendimit kritik, sipërmarrjen dhe edukimin qytetar të fëmijëve.
- Të zgjerojë mbështetjen financiare për studentët e ekselencës.
- Të realizojë dhe mbështesë sistemin e praktikantëve pranë kompanive vendase dhe të huaja
- Konsolidim i fakulteteve që janë ndarë në disa universitete, me qëllim për të rritur cilësinë e mësim-dhënies dhe rankimin e tyre.
- Të përmirësojë aftësitë digjitale të të rinjve nëpërmjet përdorimit me të avancuar të TIK.
- Të përgjysmojë shpenzimet e studentëve duke ulur tarifat e studimit. Të garantojë një paketë që siguron uljen e kostos së jetesës së studentëve ku përfshihen banimi, ushqimi, transporti e mjetet mësimore.
- Të orientojë temat studimore në Programet Master dhe Doktoraturë (PhD) në çështje konkrete të zhvillimit të ekonomisë si edhe të forcojë sistemin e bursave shtetërore sipas sektorëve prioritarë me qëllim afrimin e studentëve me kërkesat e tregut të punës.
- Të përfshijë praktikën e detyruar të punës (internship) në Bachelor dhe Master. Të përshtasë kurikulat e një ose dy viteve të fundit për studentë të

veçantë për t'ju përgjigjur nevojave të kompanive (mbi bazë marrëveshesh qeveri-privat-shkollë).

- Të masivizojë programin “Mëso dhe Fito”, duke rritur numrin e shkollave profesionale dhe gjithashtu duke përmirësuar kurrikulën profesionale të tyre, me parimin e gërshetimit të aftësisë profesionale me marrjen e dijeve teorike duke mundësuar që gjatë vitit shkollor nxënësit edhe të mësojnë, por edhe të zhvillojnë praktika pune të paguara në të njëjtën kohë.
- Të realizojë prokurim të laboratorëve të biznesit privat dhe infrastrukturën shtetërore për trajnimin praktik të shkollave dhe universiteteve.
- Të forcojë kërkimin shkencor dhe inovacionin nëpërmjet zhvillimit të kapaciteteve njerëzore, rinovimit të infrastrukturës dhe përmirësimit të Legjislacionit. Ngritje e sistemit të kërkimit shkencor dhe inovacionit në nivelin e financimit buxhetor në mesataren e BE-së.
- Të përmirësojë cilësisht sistemin e këshillimit të karrierës.
- Të kthejë sportin si një aspekt të rëndësishëm të kurrikulës shkollore. Të rrisë vlerën e sportit në kreditet akademike.
- Mbështetje për përfshirjen në sistemin arsimor dhe kërkimin shkencor të zhvillimit të koncepteve, metodave dhe teknologjive të reja për t'ju përgjigjur ndikimeve nga ndryshimet klimatike.
- Programe intensive për hyrjen e të rinjve në tregun e punës – Garancia për të rinjtë – Programi “Youth Guarantee”
  - Subvencionim për kompanitë (ku përfshihen sigurimet shoqërore/shëndetësore dhe fee me qëllim trajnimin për punonjës) për çdo të punësuar deri në moshën 29 vjeçare.
  - Ngritje e qendrave të asistimit të sipërmarrësve të rinj me trajnime dhe këshillim për menaxhim, hartim plane biznesi dhe aplikim kredie.
  - Ngritje e inkubatorëve të biznesi me qëllim nxitjen e start up-eve për zhvillimin e teknologjisë dhe inovacionit.

## KRIJIMI I ZONAVE TË LIRA EKONOMIKE

Partia e Lirisë do të angazhohet në:

- Në plotësimin e kuadrit rregullator për krijimin e zonave të lira sipas modelit të Maqedonisë së Veriut.
- Në hartimin e politikave fiskale të qëndrueshme për tërheqjen e investitorëve të huaj.
- Në nxitjen e investitorëve të huaj të investojnë në sektorë që krijojnë vlerë të lartë.
- Në promovimin e vendit për investime në zonat e lira.

- Tërheqjen e kompanive/korporatave ndërkombëtare për të vendosur selitë e tyre në Shqipëri.

## PROGRAMI I PËRMIRËSIMIT TË ADMINISTRIMIT TË FINANCAVE PUBLIKE

Shqipëria ka performancën më të ulët në mbledhjen e të ardhurave publike dhe nivelin më të ulët të shpenzimeve publike krahasuar me vendet e rajonit.

Kryefjala e Partisë së Lirisë në përmirësimin e administrimit të financave publike do të jetë

- ulja e borxhit,
- ndalimit të shpërdorimit të parave investime jo-produktive,
- reforma e sistemit fiskal,
- rritja e të ardhurave publike,
- reformë në administrimin e shpenzimeve buxhetore,
- një model të ri të shpërndarjes së të ardhurave publike.

## REFORMIMI I SISTEMIT FISKAL

Sistemi fiskal aktual ka krijuar shtrembërime dhe nxitje si për shmangie dhe evazion, duke krijuar kushte të favorshme për një kulturë informale dhe konkurrencë të tregut pa rregulla dhe pa kontroll. Si rezultat i kësaj politike, Shqipëria ka barrën tatimore më të lartë ndaj biznesit në rajon kundrejt një performancë më të ulët të mbledhjes së të ardhurave tatimore. Shqipëria ka performancën më të ulët në rajon të mbledhjes së të ardhurave nga sigurimet shoqërore në 5.8% të PBB.

Sistemi aktual i taksave është kompleks dhe i fragmentuar dhe ndryshimet e shpeshta kanë dëmtuar stabilitetin, transparencën e sistemit si dhe kanë ngushtuar më tej bazën tatimore.

Përrjashtimet jo-standarde dhe trajtimet preferenciale për grupe dhe sektorë të ndryshëm tatimpaguesish janë shtuar si pasoje e kapjes së ekonomisë nga interesat e grupeve klienteliste. Performanca e dobët në realizimin e të ardhurave është rezultat i ngushtimit të bazës tatimore, abuzimet korruptive të administratës tatimore të lidhura me oligarkët, vështirësive në administrim dhe mbledhjes joefikase.

Sistemi fiskal nuk është gjithëpërfshirës dhe i drejtë për të mbuluar të gjitha grupet e taksapaguasve dhe siguruar që të gjithë tatimpaguesit paguajnë një barrë të drejtë tatimore sipas aftësisë së tyre për të paguar. Sistemi fiskal lejon një trajtim të pabarabartë tatimor, barrë tatimore dhe shpenzimeve administrative të larta, si dhe veprimet arbitrare të organeve tatimore.

Partia e Lirisë do të angazhohet në një reformë të plotë fiskale me qëllim garantimin:

- E një sistemi fiskal që nuk lejon shtrembërime dhe krijon hapësirë për shmangie dhe evazion.
- Të një sistemi fiskal pa diferencime që lejon funksionimin e tregut me rregulla dhe konkurrencë.
- Uljen e barrës fiskale për biznesin dhe duke ofruar një taksim gjithëpërfshirës dhe të drejtë sipas aftësisë së secilit për të paguar, sipas parimit ai që fiton më shumë, paguan më shumë.
- Një sistem fiskal të qëndrueshëm dhe me një numër sa më të vogël të taksave.
- Rivendosjen e taksimit të sheshtë, duke ulur barrën fiskale, me qëllim formalizimin e ekonomisë dhe të përmirësimit të administrimit fiskal.
- Moszbatimin e regjimeve preferenciale fiskale për grupet klienteliste.
- Rritjen e autonomisë fiskale të pushtetit vendor.
- Uljen e informalitetit dhe veçanërisht të punësimit me qëllim të rritjes së kontributeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit në burim.
- Rishikimin e sistemit të taksave dhe tarifave vendore, si dhe kostot administrative të njërive të vetëqëvisjes vendore për të ulur barrën e biznesit të vogël dhe të qytetarëve.
- Rishikimin e koncensioneve të produkteve të aksizës, atyre farmaceutike, të shërbimeve doganore, etj. të cilat kanë rritur kostot e biznesit si dhe çmimet finale të konsumatorit.
- Reduktim të shkallës së TVSH për produktet ushqimore të shportës, produktet për fëmijë, barnat dhe shërbimet mjekësore dhe furnizimin e energjisë elektrike për konsumatorët familjarë.
- Forcimin e administratës tatimore dhe doganore për uljen e evazionit dhe shmangiet tatimore.
- Rritjen e kontrollit të administratës tatimore dhe doganore për të frenuar abuzimet me rritjen e çmimeve dhe në veçanti të atyre ushqimore dhe të shërbimit mjekësor.

## ADMINISTRIMI ME EFEKTIVITET I SHPENZIMEVE BUXHETORE

Shpërndarja e të ardhurave nga taksat e mbledhura do të mbështesë qytetarin, dhe jo interesat klienteliste të qeverisë.

Praktikat e shpërndarjes së fondeve publike tregojnë rritjen e shpenzimeve të koncensioneve korruptive për shërbimet, rritjen e fondit të investimeve në funksion të financimit të PPP, rritjen e shpenzimeve të luksit, si dhe rritjen e kostos së borxhit publik. Ndërsa shpenzimet e personelit, përfshi pagat, janë ulur, transfertat për pushtetin vendor ka mbetur në të njëjtin nivel, dhe shpenzimet sociale janë ulur gjithashtu. Shqipëria mbeti vendi me nivelin më të ulët të mbështetjes fiskale për

grupet sociale në nevojë në periudhën e pandemisë, por dhe në vazhdim për mbrojtjen e tyre nga rritja galopante e çmimeve.

Partia e Lirisë do të angazhohet në një reformë gjithë-përfshirëse të ndalimit të shpenzimeve jo-produktive dhe pa interes publik. Për këtë do të realizojë:

- Rishikim ligjor i kontratave të PPP.
- Uljen e kostove të larta korruptive në krahasim me praktikën e vendeve europiane dhe të rajonit të projekteve të investimeve të infrastrukturës.
- Ndalimin e shpenzimeve të luksit dhe të shpenzimeve të panevojshme operative të institucioneve publike.
- Përmirësim në menaxhimin e borxhit publik dhe uljen e kostos së shërbimit të tij.
- Ndalimin e praktikave të marrjes borxh të huaj për investime joproduktive.

Partia e Lirisë do të angazhohet në një reformim të modelit të rishpërndarjes me në qendër qytetarin dhe grupet sociale në nevojë. Modeli i ri i shpërndarjes të të ardhurave do të synojë me prioritet që fondet publike të përdoren për rritjen me përparësi të pensioneve, ndihmës ekonomike, të pagave të administratës publike, të shpenzimeve dhe investimeve në arsim dhe shëndetësi, rritjen e shpenzimeve sociale për të ndaluar shpopullimin e vendit.

Konkretisht ne do të realizojmë:

- Rritjen dhe indeksimin e pagave me ligj në përputhje me rritjen e çmimeve për të mbrojtur nivelin e jetesës së punonjësve.
- Ndalimin e praktikave të rritjes së diferencuar të pagave në zbatim të parimit që e drejta e detyrimit të pagimit të taksave dhe e përfitimit të rritjes së pagave është e barabartë për të gjithë
- Rritjen reale të pensioneve të zonave urbane dhe rurale të gjitha kategorive.
- Programi për uljen e varfërisë do të kërkojë rritjen e pagesës për ndihmën ekonomike, mbështetjen e familjeve me paketa financiare për të përballuar shpenzimet e energjisë, ujit, transportit dhe atyre sociale, si dhe mundësitë e punësimit me përparësi të tyre.

## SHËNDETËSIA DHE SHËNDETI PUBLIK

Në qendër të vëmendjes për të krijuar sigurinë e jetës së qytetarit qëndron shëndeti publik, që është një detyrë parësore e qeverisë.

Partia e Lirisë synon të rrisë sigurinë dhe kontrollin mbi të gjithë elementët që ndikojnë në shëndetin publik: ushqimi, uji, mjedisi, shërbimi shëndetësor, stili i jetesës.

E rëndësisë së veçantë është përgatitja e planeve kombëtare kundër pandemive me një vend të veçantë për edukimin dhe parandalimin.

Masa të tjera të rëndësishme janë:

Hartimi i një plani kombëtar për parandalimin e sëmundjeve me vdekshmëri të lartë: sëmundjet e zemres dhe tumorët.

Trajtimi i komplikacioneve të Covid.

Konsolidimi i skemës së sigurimeve shëndetësore si element kyç në menaxhimin e sistemit shëndetësor.

Konsolidimi dhe zbatimi i Sistemit të Referimit.

Decentralizimi i kompetencave të Ministrisë së Shëndetësisë.

Rritja e pagave, sipas nivelit mesatar të rajonit.

Pasurimi i tregut të barnave me shumë më tepër molekula se sa aktualisht, goditje e fortë kontrabandës dhe rikthimit të kompanive brand-name në Shqipëri.

Realizimi i autonomisë së shërbimit spitalor.

Ringritje e shërbimit cilësor të Mjekut të Familjes dhe shërbimit parësor në tërësi.

Forcim i dënimit për ata që shpërndajnë lëndë narkotike tek minorenët.

\*\*\*

## **MBËSHTETJE E GRUAS DHE FAMILJEVE TË REJA -NDIKIM I DREJTËPËRDREJTË NË NDALIMIN E SHPOPULLIMIT**

Mbështetja e gruas dhe familjes është kauze madhore e Partisë së Lirisë.

Për këtë do të realizohet:

Fuqizimi Ekonomik dhe Social i Gruas nëpërmjet programit “arsim për punësim”, në mënyrë që gratë të fuqizohen ekonomikisht, veçanërisht, gratë dhe vajzat që u përkasin shtresave më në nevojë të popullsisë.

“Strategjia për Gruan Sipërmarrëse”, një pakete masash stimuluese financiare dhe fiskale për arsimimin, kualifikimin, trajnimin, zhvillimin dhe promovimin e iniciativës private për vajzat dhe gratë.

Intensifikimin e luftës kundër dhunës ndaj grave dhe vajzave, kryesisht dhunës në familje, në ambientin publik dhe në vendin e punës.

Mbështetje dhe stazhe në biznese për të ndihmuar gjetjen e punës së parë për vajzat që mbarojnë shkollën dhe paralelisht, si dhe do të shtojmë edhe stazhet në administratën publike.

Dedikimin e programeve të veçanta për nxitjen e start-up-eve nga vajzat dhe gratë nëpërmjet mundësimit të linjave të veçanta të kreditimit me norma interesi të ulëta për këto biznese të reja dhe integrimi në tregun e punës.

Rishikimin e kuadrit ligjor për dhunën dhe diskriminimin me bazë gjinore si dhe monitorimi i vazhdueshëm i masave dhe buxheteve të dedikuara për këtë aspekt në nivel qendror dhe lokal.

Monitorimi në bashkëpunim me shoqërinë civile i zbatimit të ligjit të miratuar tashmë nga Parlamenti Shqiptar “Regjistrin Kombëtar të të Dënuarve për Krime Seksuale”.

Mbështetja e grave kryefamiljare me politika më sociale, duke evituar pengesat burokratike në mbështetjen sociale të tyre, si dhe duke i bërë pjesë të programeve të fuqizimit ekonomik.

Mbështetja e familjeve të reja me mekanizma të ndryshëm financiare si kredi të buta (dhe mekanizma të tjerë) për strehim. Rritje progresive pagesave për fëmijën e dytë e të tretë.

Garantimi i aksesit dhe fuqizimi i grave dhe vajzave për të marrë pjesë në të gjitha proceset vendimmarrëse, në nivel qendror dhe lokal.

Ulja e TVSH për produktet për fëmijët deri në 5 vjeç, për veshje, ushqime, libra, lodra.

Forcimi i ndihmës ekonomike për gruan kryefamiljare dhe për të porsalindurit.

Rritje e ndihmës sociale për fëmijët në familje me prindër të divorcuar.

Masa të tjera:

Rritje e mbështetjes për individët me aftësi të veçanta dhe/ose punësim në përshtatje me aftësitë e tyre.

Partia e Lirisë do të mbështesë qytetarët me dëmtime fizike e pluridifekte, që nuk mbulohen nga skema e sigurimeve shoqërore dhe që kanë nevojë për mbështetje për shkak të pamundësisë së përballimit të jetesës dhe të çmimeve të larta.

Për t'i ardhur në ndihmë kësaj kategorie Partia e Lirisë do të mbështesë në programin e saj:

- Pagesën e sigurimeve shoqërore për kategorinë e ndihmësave të PAK.
- Udhëtimin falas në sistemin e transportit nder-qytetas me autobus dhe tren.

.....

Mbi bazën e këtij dokumenti, që përmban:

Kauzat Kryesore

Parimet dhe vlerat

Politikat dhe masat kryesore sektoriale

Partia e Lirisë do të fillojë një proces konsultimi dhe pasurimi të tij me anëtarësinë, grupet e interesit dhe profesionistët e fushave, për të përgatitur programin e saj zgjedhor për zgjedhjet e ardhshme.

KONVENTA KOMBETARE E PARTISE SE LIRISE

29 TETOR 2022